**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova/Republic of Kosovo**
**Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality**

---

Kryetari i Komunës
02 Nr. 404/1- 2018
Dt:13.01.2020
Dragash

Në bazë të nenit 14 paragrafi 14.3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjën Lokale, ne bazë të rregullorës të Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare në Organizatat Buxhetore si dhe nenit 53 të Statusit të Komunës së Dragashit, Kryetari merrë këtë:

# Vendim

Organizata buxhetore duhet të bëjë vleresimin e pasurise financiare per te vertetuar nevojshmerine e pasurise jo financiare per organizaten, gjendjen fizike dhe mundesine per ta perdoruar ne njesite tjera te organizates:
Formohet komisioni per vleresimin e pasurise jo financiare te Komunës së Dragashit:

1. Xhevat Isufi
2. Usamidin Haruni
3. Sylejman Jonuzi

Ky komision ka për detyrë të bëjë vlerësimin e pasurisë së identifikuar si pasuri në gjendje të rregullt por që nuk është duke u përdorur, apo vlerësimin e pasurisë së dëmtuar apo jashtë përdorimi dhe në bazë të vlerësimit të jap rekomandime si në vijim:

a. Pasuria të transferohet në ndonjë departament tjetër të komunës që ka nevojë për aset të tillë
b. Të kaloj në procedura të shitjes
c. Ti falet ndonjë organizate në nevojë
d. Të asgjësohet

Komisioni bënë vizitën në zyrën, departamentin apo objektin ku gjinden asetet
Varësisht nga konstatimi i gjendjes përpilon raportin i cili përmban dhe rekomandime
Raporti i përfunduar dhe i nënshkruar nga zyrtarët e komisionit dorëzohet te personat përgjegjës: ZKA, ZKF dhe Drejtori Financiar
Në bazë të rekomandimeve në raport, ZKF merr vendim për hyrje në procedure të tjetërsimit të pasurisë

Kryetari komunës
Shaban Shabani

**Republika e Kosovës Republika Kosova**
**/Republic of Kosovo**
**Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine**
**Dragaš/Dragas Municipalit**

---

**Kryetari i komunës**
**02 Nr.** 400/3-1015
**Dt.14.01.2020**
**Dragash**

Duke u bazuar në nenin 58 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale dhe Marrveshjen e bashkepunimit dhe bashkefinancimit ne mes te shoqates bamirese Jetimat e Ballkanit dhe Komunes se Dragashit me nr te protokollit 02.NR .400/01-11624/19 te dates 25.09.2019 dhe ne Raportin e punes se ndertimit te shtepive per familjet me kushte te renda ekonomike te bashkefinancuar nga Komuna e dragashit te dates 25.11.2019 me nr te protokollit 02 Nr.400/01-31318, Kryetari i Komunës merrë këtë:

Vendim

1. Emerohet komisioni I pranimit te projektit " Ndertimi I shtepive per familjet me kushte te renda ekonomike ne Komunen e Dragashit"
2. Flurim Krasniqi
   Xevat Isufi
   Vetim Hasani

3. Komisioni duhet te kontrolloje se punimet a jane kryer ne baze te marrveshjes

Vendimi I dergohet:
Antareve te komisionit
Arkivit

Kryetari i Komunës
Shaban Shabani

02 Nr. 400/1-1902
23.1.20
Dragash - Dragaš

FORMULARI 2 - VENDIM PER SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PER MBESHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PER PROJEKTE/PROGRAME TE ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE

KOMUNA E DRAGASHIT

Në bazë të nenit 58, ligjit për Vetqeverisje Lokale 031-40, dhe nenit 12 te rregullorës mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve 04/2017, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

**VENDIM**

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programe të organizatave jo-qeveritare në fushën e Kulturës.

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullorës mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik te OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Zyrës së Kryetarit, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nenprogramit 160/16009 dhe Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit e nënprogramit 850/85009.

II

2. Mjetet e përmendura në nenin do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve te OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:
    1. Teksti i thirrjes publike
    2. Udhëzimet për aplikantët
    3. Formularët e aplikimit
    4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
    5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin e këtij neni janë:
    1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
    2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
    3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta
    4. Deklaratat e Partneritetit (nese EshtE e aplikueshme)
    5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve tö OJQ-ve të financuara nga burimet publike.
    6. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin I të këtij neni janë:

    1.Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
    2.Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
    3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar te programit apo projektit

IV

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare: https://kk.rks-gov.net/dragash/category/shpalljet/thirrje-per-propozime

V

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regiistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuara që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit I të këtij neni.

3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. . Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.

2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.

3. Përgjegiës për zbatimin e këtij vendimi është Dreitoria per Kulture Rini dhe Sport

VII

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Udhëheqësi i institucionit

Emri i plotë dhe pozita

Shaban Shabani, Kryetar

**20.01.2020**

*Republika e Kosovës*
*Rpublika Kosova/ Republikc of Kosovo*
*Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opština Dragaš / Daragas Municipality*

**Dragash**
**Dt.23.01.2020**

Bazuar në nenin 13 dhe neni 58 të ligjit për Vetqeverisjen Lokale dhe neni 58 të statutit të Komunes së Dragashit,kryetari i Komunes bie këtë;

# *VENDIM*

**I**

*TË SIGUROHEN*,për;

- **Shkollat fillore dhe shkollën e mesme**
- Derivate per gjenerator per nevojat e shkollave në shumë prej **20 litrave në muaj**

**II**

Për implementimin e këti vendimi, obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Drejtorat e shkollës

**III**

Për hapat e ndërmarrë në lidhje me këtë qështje, të njoftohet kryetari i Komunës.

**IV**

**Ky vendim hyn në fuqi nga dt.01.02.2020**

*I dergohet;*
-Drejtorisë për Arsim
-Drejtorave të Shkollave
-Zyres së Prokurimit
-OE- Delta Grup
-Arkivit

**Kryetari i Komunes**
**Shaban Shabani**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš
02 Nr. Br. 400/01-1907/20
24.01.20 20
Dragash - Dragaš

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosovo/Republic of Kosovo**

**Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality**

**Kryetari i Komunës**
**02 Nr.** 02/1- 7244
**Dt. 29.01.2020**

**Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) ,nenit 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 57 të statutit të Komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, kryetari i Komunës merr këtë:**

# VENDIM
## PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR PLATFORMËN E KONSULTIMEVE PUBLIKE

**I**

**CAKTOHET z. Valon Shabani** zyrtar përgjegjës për menaxhimin me platformën e Konsultimeve Publike dhe koordinimin e zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në komunë.

**II**

Detyrë e zyrtarit është që ti ndjek procedurat e konsultimit publik siç është e paraparë në Udhëzimin Administrativ i cili është në shtojcën e këtij Vendimi

**III**

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

*Shtojcë:*

1. Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna
2. Kërkesa e MAPL-së nr.030-63 e datës 22.01.2020

**Kopja e vendimit i dërgohet:**

**1.z. Valon Shabani ,**
**2. Arkivit**

**Kryetari i Komunës**
**Shaban Shabani**

Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality

**Kryetari i Komunës**
**02 Nr.** 016/1- 2246
**Dt. 29.01.2020**

**Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 57 të statutit të Komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, si dhe në bazë të kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr.030-63 të datëss 22.01.2020, kryetari i Komunës merr këtë:**

# VENDIM
## PËR CAKTIMIN E ZYRTARVE PËRGJEGJËS PËR PËRFORMANCË

**I**

**CAKTOHEN** Zyrtaret përgjegjës për përformancë komunale në fushat: Arsim, Shëndetësi, Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Barazi Gjinore:

1. Znj. Alltane Tershnjaku, në fushën e Arsimit,
2. Z. Fitim Karimani, në fushën e Shëndetësisë,
3. Z.Valon Shabani, në fushën e Zhvillimit Ekonomik dhe
4. Znj. Lindita Piraj, në fushën e Barazisë Gjinore.

**II**

Detyrë e zyrtarëve të lartcekur është menaxhimi efikas i të dhënave të sistemit të menaxhimit të përformancës komunale si dhe raportimi në fushat e caktuara.

**III**

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

*Shtojcë:*

1. Kërkesa nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

**Kopja e vendimit u dërgohet:**

**1.Zyrtarëve të lartcekur**
**2. Arkivit**

**Kryetari i Komunës**
**Shaban Shabani**